

**S T A T U T I**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“POWATEC CONSTRUCTION”**

Ne kete statut

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare”;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;

**Kreu I**

**THEMELIMI,EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA,SELIA,**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me date 10/10/2022, ne themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me emrin POWATEC CONSTRUCTION shpk.

Themeluesit e shoqerise jane :

- **Teri Suzan Pojani**, lindur e banues ne Tirane, i dtl.20/10/1961- (**ID G11020184N**)
- **Dhanil Dhimitraq Leno**, lindur e banues ne Tirane, i dtl.16/03/1961- (**ID G10316062Q**)

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqeria do te kryej aktivitetin e meposhtem:

- *Aktivitet ne fushen e ndertimit te te gjitha llojeve duke perfshire ketu, ndertimet per qellime banimi, ndertime me karakter social, ose kulturor, industrial, kanalizime, rehabilitime rruges, ndertimin e tyre, etj.*
- *Import-eksport dhe shitblerje me shumice e me pakice te mallrave industriale, ushqimore, blektorale, bujqesore,ndertimore, minerare, etj.*
- *Ofrimin e sherbimeve qe kane te bejne me administrimin e bashkepronesise ne ndertesat e banimit dhe sherbimit, konkretisht sherbime qe konsistojne ne mirembajtjen e siperfaqeve te perbashketa te godinave te banimit dhe sherbimit, siperfaqeve rekreative dhe hapësirave funksionale te tyre.*
- *Ofrimi i sherbimeve qe kane te bejne me projekte arkitekturore per objekte banimi, objekte industriale, objekte turistike, plane te detajuara vendore, projektim interiere, projektim pejsazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe,etj.*
- *Ushtrim i aktivitetit tregtar ne fushen e sherbimit te parkimit dhe administrimit te ketij sherbimi, me teknologjine dhe burimet njerezore te shoqerise.*
- *Aktivitet tregtar sportiv, park dhe kend lojerash te pajisura me lojera per femije.*
- *Veprimtari tregtare ne fushen e ushqimit social, bar-bufe, restorante, hoteleri dhe aktivitet turistik.*
- *Tregetim te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere,industrial e ushqimore, lende te para, materiale, paisje dhe makineri te llojeve te ndryshme e pjese kembimi per to, me shumice e pakice, me importe dhe eksporte*
- *Konsulence tregtare e marketingu, sherbime te tjera te ngjashme.*

- *Prodhim e tregetim te materialeve te ndryshme qe nevoiten per ndertimin dhe kopletimin e objektve nderitimore.*
- *Si dhe çdo veprimtari tjetër, qe veçmas ose sebashku me ato te permendura me sipër do te konsiderohet e pershtatshme dhe me leverdi per rritjen e zhvillimin e shoqerise tregtare.*

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Siri Kodra, Blloku Magazinave, Tirane me nr. Pasurie 5/196, zona kadastrale 8340. Ajo mund te transferohet ne çfaredo vendi tjetër brenda qytetit te Tiranës ose ne ndonje qytet tjetër te Republikës se Shqipërisë me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

### **Kreu II**

#### **KAPITALI**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 500,000 Leke. Pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise eshte si me meposhtme:

1. **Teri Pojani :** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 250,000 leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **Dhanil Leno:** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 250,000 leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimet e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjithe rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e nje kapitali te nje shoqerie me pergjigjesi te kufizuar e te drejta qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributet ne kapitalin e shoqerise.
- b) shitblerjes.
- c) trashegimise.
- d) dhurimit.
- e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne kete statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) ndryshimet e statutit.
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- d) emerimin e shkarkimin e likujdatoreve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- e) percaktimin e shperblimeve personave permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare dhe te administrimit, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- h) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne proçedimet e tjera ndaj administratoreve.
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- l) miratimin e rregullave proçedurale te mbledhjeve te asamblese.
- m) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblen e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 9**

## **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrim apo mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavarsisht parregullsisse.

### **Neni 10 Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e mumrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo ne menyre elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise.
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- c) emerimin e shkarkimiv e likuidatorve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) percaktimin e shperblimeve.
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate e ne proçedurat e tjera ndaj administratoreve.
- g) miratimin e rregullave proçeduriale te mbledhjeve te asamblese.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12 Perjashtim nga e drejta e votes**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij.
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria.
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar , i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### Neni 13


#### Administrimi

Asambleja e pergjitheshme emerone nje ose me shume persona fizike si dhe administrator te shoqerise afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit te Biznesit.

Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administrator te nje shoqerije te kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

Administrator i shoqerise emerohet z.Donald Dhanil Leno, dtl. 19/07/1990, lindur dhe banues ne Tirane, Shqiperi, ne adresen Rruga "Bulevardi Zog i Pare", Pall.32, Shk.3, Ap.30 dhe me nr.personal (ID) J00719070N.

dhe specimenet te nenshkrimet:



### Neni 14

#### Kompetencat e administratoreve

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjitheshme.
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare.
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- d) pergatise dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjitheshme per miratim.
- e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- f) kryeje rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit.
- g) raportoje perpara asamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- h) kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjitheshme ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

- b) shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kene nje vlere me te larte se 5% te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- c) shoqeria, brenda dy viteve te parapas rregjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

Nese asambleja e pergjitheshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontaktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marredhenieve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perceç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjitheshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit "Per tregtarete dhe shoqerite tregtare",

#### **1. Administratori detyrohet:**

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi , duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
- c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim.
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise.
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te aresyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te veçante por pa u kufizuar me to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese ne kundershtim me dispozitat e ligjit " Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet.
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividend.
- c) u shperndan aktivet shoqerise.
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregetare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
- e) jep kredi.

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **Kreu IV** **VITI FINANCIAR –EKSPERTET**

##### **Neni 16** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqise e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V** **PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

##### **Neni 18** **Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit.
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit".
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje lukujdues.

#### **Neni 19**

##### **Riorganizimi i shoqerise bashkimi – ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare."

#### **Neni 20**

##### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Per sa nuk parashkohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtare dhe shoqeri tregtare", Kodi Civil dhe çfardo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 21**

##### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshje qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si pe çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKET E SHOQERISE "POWATEC CONSTRUCTION " shpk**

**Teri Pojani**

**Dhanil Leno**